

Vendim nr. 23 datë 05.02.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare

Marjana Semini, Anëtare

Marsida Xhaferllari, Anëtare

në datën 05.02.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 14 (S) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: SINAN TAJAJ

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Shfuqizimi i nenit 238 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.

Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2021-733 (73), datë 27.05.2021 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-2054 (176), datë 12.05.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, 18, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED) i vitit 2019, me vendimet nr. 79, datë 30.07.2019 (vendimi nr. 79/2019), nr. 80, datë 30.07.2019 (vendimi nr. 80/2019), nr. 81, datë 30.07.2019 (vendimi nr. 81/2019), nr. 82, datë 30.07.2019 (vendimi nr. 82/2019), i ka ndaluar kërkuesit Sinan Tafaj kandidimin për vendet vakante për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata) të shpallura nga Kuvendi dhe Presidenti i Republikës.

2. Procedura e verifikimit të kushteve dhe kriterëve kushtetuese e ligjore të kërkuesit është bazuar në dispozitat e Kushtetutës, ligjit nr. 8577/2000, ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar (ligji nr. 115/2016) dhe vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 të KED-së “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” (vendimi nr. 4/2019). Kërkuesi i ka kundërshtuar gjyqësisht vendimet nr. 79/2019, nr. 80/2019, nr. 81/2019 dhe nr. 82/2019 të KED-së në një padi të vetme.

3. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 200, datë 22.08.2019 (vendimi nr. 200/2019), ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se ajo ishte e pambështetur në prova dhe në ligj. Në dispozitivin e vendimit, gjykata është shprehur se “vendimi është përfundimtar dhe i formës së prerë”. Gjithashtu, në këtë gjykim, gjykata e apelit ka rrëzuar edhe kërkesën e kërkuesit për shtimin e objektit të padisë, për të përfshirë edhe shfuqizimin e vendimit nr. 4/2019 të KED-së. Gjykata ka argumentuar se bazuar në nenin 185 të KPC-së, shfuqizimi i vendimit nr. 4/2019 përbën një kërkim të ri që nuk mund të gjykohet nga ai trup gjykues. Kundër vendimit përfundimtar, kërkuesi ka paraqitur rekurs, i cili nuk është pranuar nga Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin e datës 04.10.2019, me arsyetimin se sipas pikës 2 të nenit 238 të ligjit nr. 115/2016 dhe shkronjës “c”, të nenit 450 të KPC-së, vendimi i kundërshtuar është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankimi.

4. Në datën 08.10.2020 kërkuesi ka paraqitur sërish padi në atë gjykatë duke kërkuar vetëm shfuqizimin e vendimit nr. 4/2019 të KED-së. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 57, datë 30.09.2022, ka vendosur mospranimin e padisë, me arsyetimin se vendimi i kundërshtuar është akt nënligjor normativ dhe kërkuesi nuk legjitimohet për ngritjen e saj. Në pjesën arsyetuese gjykata e apelit i është referuar, ndër të tjera, edhe vendimit nr. 00-2021-733

(73), datë 27.05.2021 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë (*vendimi nr. 733/2021*). Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesi.

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-2054 (176), datë 12.05.2023 (*vendimi nr. 176/2023*), ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, me arsyetimin se ishte në përputhje me ligjin procedural, jurisprudencën e konsoliduar të vetë kolegjit, si dhe me standardet kushtetuese.

6. Ndërkohë, kërkuesi ka paraqitur kandidaturën për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese edhe tri herë të tjera dhe KED-ja e vitit 2020 dhe e vitit 2021, pasi ka kryer verifikimet përkatëse, me vendimet nr. 30, datë 05.10.2020 (*vendimi nr. 30/2020*), nr. 3, datë 31.08.2021 (*vendimi nr. 3/2021*) dhe nr. 9, datë 31.08.2021 (*vendimi nr. 9/2021*) ka vendosur sërish ndalimin e kandidimit të tij. Edhe këto vendime janë kundërshtuar gjyqësisht nga kërkuesi. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimet nr. 90, datë 06.11.2020 (*vendimi nr. 90/2020*) dhe nr. 61, datë 17.09.2021 (*vendimi nr. 61/2021*) ka rrëzuar paditë e kërkuesit, me arsyetimin se aktet objekt kundërshtimi kanë dalë në përputhje me ligjin dhe provat. Në dispozitivin e të dyja vendimeve gjyqësore, gjykata është shprehur se “*vendimi është përfundimtar dhe i formës së prerë*”.

7. Nga ana tjetër, kërkuesi, në cilësinë e personit të tretë, ka paraqitur ankim edhe ndaj vendimit nr. 1768, datë 07.06.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë që nuk ka pranuar padinë e Shoqatës së të Verbërve në Shqipëri për shfuqizimin e paragrafit 56 të vendimit nr. 30/2020 të KED-së lidhur me ligjshmërinë e marrjes së pagesave të doktoraturës. Ankimi, sipas kërkuesit, ndodhet ende në proces gjykimi.

8. Në datën 25.10.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për shfuqizimin e vendimin nr. 4/2019 të KED-së, si të papajtueshëm me Kushtetutën; shfuqizimin e nenit 238 të ligjit nr. 115/2016, si të papajtueshëm me Kushtetutën; shfuqizimin e vendimit nr. 176/2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe shfuqizimin e vendimit nr. 733/2021 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën. Kërkesa, pasi është plotësuar me dokumentet e kërkuara, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 20.11.2023.

II

Pretendimet e kërkuesit

9. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi nr. 4/2019 i KED-së, neni 238 i ligjit nr. 115/2016 dhe vendimet nr. 176/2023 dhe nr. 733/2021 të Gjykatës së Lartë

janë antikushtetues, pasi shkelin të drejtat e garantuara nga nenet 4, 17, 18, 42 dhe 43 të Kushtetutës, si dhe nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së. Sipas tij:

9.1. *Vendimi nr. 4/2019 i KED-së* cenon të drejtën për proces të rregullt ligjor, në aspektet e mëposhtme:

9.1.1. *Parimin e objektivitetit*, pasi ndonëse është një akt administrativ, ai është ngritur në nivelin e një kodi procedural për këtë fushë specifike dhe nuk rregullon në mënyrë transparente, të ndershme dhe të ekuilibruar të gjitha marrëdhëniet e palëve në proces. Ai ka injoruar parimet e procedurës administrative të lidhura me procedurat e shqyrtimit administrativ, me të drejtën e përfaqësimit, respektimin e afateve në paraqitjen e provave dhe detyrime të tjera.

9.1.2. *Parimin e barazisë para ligjit dhe të kontradiktoritetit*, pasi ka ndaluar debatin dhe nuk u ka krijuar shanse të barabarta palëve që të dëgjoheshin, të kundërshtonin, të sillnin dhe të risillnin prova.

9.1.3. *Standardin e arsyetimit*, pasi vendimi i KED-së nuk arsyeton plotësisht shkaqet për mospranimin e të gjitha provave dhe fakteve, me qëllim dhënien e mundësisë për kundërshtimin e relacionit përfundimtar dhe për të kuptuar, në rastin konkret, qëndrimin e KED-së lidhur me shkakun e moskualifikimit të tij.

9.1.4. *Parimin e mosdiskriminimit*, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi në rastin e tij vendimi ka krijuar disproporcion dhe pabarazi për shkak të statusit të verbërisë.

9.1.5. *Parimin e sigurisë juridike*, të garantuar nga neni 4 i Kushtetutës, pasi KED-ja në vlerësimin e rastit e tij ka dalë përtej përcaktimeve të vendimit, ndërkohë që ky i fundit nuk ka parashikuar rishikimin e vendimmarrjes për çështje konkrete ligjore materiale, veçanërisht kur lidhen me zbatimin e tij.

9.2. *Neni 238 i ligjit nr. 115/2016* cenon:

9.2.1. *Të drejtën e ankimit*, pasi kufizon individët për të kundërshtuar vendimin e KED-së dhe zvogëlon juridiksionin gjyqësor të Gjykatës Administrative të Apelit.

9.2.2. *Parimin e pavarësisë, paanshmërisë, objektivitetit dhe ligjshmërisë*, pasi nuk ka parashikuar procedura të plota për ofrimin e këtyre garancive. Ndërkohë është e paqartë se çfarë do të thotë “shkelje e rëndë procedurale”.

- 9.2.3. *Parimin e transparencës*, pasi mbledhjet e KED-së zhvillohen në një proces të mbyllur, me përfshirjen e një rrethi të ngushtë aktorësh.
- 9.3. *Vendimet nr. 176/2023 dhe nr. 733/2021 të Gjykatës së Lartë* cenojnë:
- 9.3.1. *Të drejtën e aksesit*, pasi kjo praktikë i ka krijuar kufizime individit në drejtësi për të mbrojtur interesat e tij ndaj një akti normativ. Interpretimi i neni 15, shkronja “d”, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, duke përdorur termin “vetëm” është shkelje e rëndë e ligjit procedural administrativ.
- 9.3.2. *Të drejtën për mbrojtje efektive*, pasi e lënë individin pa asnjë mjet tjetër në dispozicion për t’u mbrojtur.
- 9.3.3. *Të drejtën për gjykim të drejtë*, pasi në rastin e tij Kolegji Administrativ ka dalë jashtë juridiksionit të tij, duke u sjellë si organ administrativ që jep orientime dhe vlerësime që shkojnë në favor të KED-së dhe jo të interesit publik, i cili përfaqëson edhe interesin e individit.
- 9.3.4. *Standardin e arsytimit të vendimit*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar përse i është referuar vetëm vendimit nr. 30/2020, i cili është një nga shtatë vendimet e KED-së të dhëna ndaj tij. Vendimi nr. 30/2020 është bërë objekt kundërshtimi, por Gjykata Administrative e Apelit e ka ndaluar ankimin dhe rekursin ndaj tij, për rrjedhojë kërkuesi nuk kishte çfarë t’i kërkonte gjykatës lidhur me këtë vendim. Ndërkohë që kundërshtimi i tij, në thelb, lidhej me qëndrimin e KED-së për paligjshmërinë e pagesës së doktoraturës si i verbër dhe me faktin se ky vlerësim është vendosur në themel të vendimmarrjes së ndalimit të kandidimit të tij.

III

Vlerësimi i Kolegjit

10. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” e 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

11. Nga ana tjetër, nenet 49, pika 3, shkronja “e” dhe 71, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000 parashikojnë se objekt i ankimit kushtetues individual, në raste të veçanta, mund të jetë edhe ligji ose akti normativ. Gjykata ka pohuar se në këto raste kërkuesi legjitimohet nëse plotësohen bashkërisht këto kritere: (i) legjitimimi *ratione personae*, në kuptimin që individi provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar, si dhe provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese; (ii) shterimi i mjeteve juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose individi provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm; (iii) legjitimimi *ratione temporis*, në kuptimin që individi ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit; (iv) legjitimimi *ratione materiae*, në kuptimin që individi provon se pretendimet e ngritura janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, pra të drejtat dhe liritë themelore, që pretendohen se janë cenuar, janë të garantuara në Kushtetutë, si dhe shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur (*shih vendimet nr. 34, datë 12.06.2023; nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Për sa i takon kriterit për legjitimimin *ratione personae*, Gjykata ka pohuar se sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individi është subjekt i kushtëzuar. Si i tillë, ai mund të paraqesë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, duke provuar se është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të. Kjo do të thotë se kërkuesi duhet të provojë legjitimimin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Në këtë këndvështrim, në parim, statusi i “viktims” përjashtohet vetëm nëse organet publike kanë njohur shkeljen, në mënyrë të shprehur ose në substancë, dhe më pas e kanë riparuar atë (*shih vendimet nr. 64, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke parashtruar 3 kërtime: (i) *kërkimi i parë* lidhet me shfuqizimin e vendimit nr. 4/2019 të KED-së, i cili ka shërbyer si bazë ligjore për KED-në në dhënien e 7 vendimeve që kanë ndaluar kandidimin e tij; (ii) *kërkimi i dytë* lidhet me shfuqizimin e nenit 238 të ligjit nr. 115/2016, që sipas kërkuesit kufizon fushën e ankimeve ndaj vendimeve të KED-së (vetëm për shkelje të rënda procedurale) dhe nuk lejon rekursin në Gjykatën e Lartë; (iii) *kërkimi i tretë* lidhet me shfuqizimin e dy vendimeve të Gjykatës së Lartë, nr. 176/2023, që ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit për rrëzimin e padisë ndaj vendimit nr. 4/2019 të KED-së dhe nr. 733/2021.

14. Lidhur me kërkimin për shfuqizimin e vendimit nr. 733/2021 të Gjykatës së Lartë, Kolegji vëren se ai është dhënë në një proces gjyqësor në të cilin kërkuesi nuk është palë, pra i përket një individi tjetër, i cili ka kundërshtuar një urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm që rregullon shërbimin e gatishmërisë në prokurori. Për rrjedhojë, kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae*, pasi nuk provon interesin e drejtpërdrejtë të tij për shfuqizimin e atij vendimi.

15. Për sa u takon pretendimeve për shfuqizimin e vendimit nr. 4/2019 të KED-së, Kolegji konstaton se kërkuesi në datën 08.10.2020 e ka kundërshtuar këtë akt veçmas në Gjykatën Administrative të Apelit. Kjo e fundit ka vendosur mospranimin, me arsyetimin se ai nuk legjitimohej në ngritjen e padisë, pasi vendimi nr. 4/2019 përbënte akt normativ dhe si i tillë nuk mund të kundërshtohet nga kërkuesi si individ, i cili mund dhe duhet t'i mbrojtë interesat e tij duke kundërshtuar akte administrative individuale. Sipas Gjykatës Administrative të Apelit, në gjykim është provuar dhe pranuar nga palët ndërgjyqëse se në zbatim të vendimit nr. 4/2019 të KED-së ka dalë edhe vendimi administrativ nr. 30/2020, me natyrë individuale, i cili sipas paditësit (kërkuesit) i ka cenuar atij të drejtën për t'u kualifikuar dhe ndaj të cilit ai ka ngritur padi në gjykatë (*shih faqet 21-22 të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit*).

16. Në të njëjtën linjë arsyetimi, edhe Gjykata e Lartë, duke vlerësuar se individi nuk legjitimohet të kundërshtojë akte nënligjore që përmbajnë rregullime abstrakte, zbatimimi i të cilave detyrimisht kërkon një akt individual për zbatimin e normës nënligjore, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit. Sipas Gjykatës së Lartë, vendimi nr. 4/2019 i KED-së i ka sjellë efektet e kërkuesit me vendimin nr. 30/2020, i cili nuk rezulton të jetë kundërshtuar prej tij në padinë e paraqitur dhe as të jetë kërkuar gjatë gjykimit shtimi i objektit, për rrjedhojë nuk ka qenë pjesë e shqyrtimit gjyqësor. Në këto kushte, ka argumentuar Gjykata e Lartë, kërkuesi në të drejtat e pretenduara (mund të) cenohet nga akti individual i pakundërshtuar gjyqësisht në këtë gjykim (*shih paragrafin 22 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

17. Kolegji vë në dukje se vendimi nr. 4/2019 i KED-së përcakton rregulla të hollësishme lidhur me procedurat që KED-ja zhvillon për verifikimin e pasurisë, integritetit, së shkuarës profesionale dhe personale, si edhe të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore që duhet të plotësojnë kandidatët për t'u zgjedhur në pozicionet vakante për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor të Lartë të Drejtësisë. Në zbatim të tij, KED-ja kryen procedurën e verifikimit dhe në përfundim nxjerr vendime për kualifikimin ose jo të kandidatëve, që plotësojnë ose nuk plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore. Kjo do të thotë se akti i cili prodhon efekte të drejtpërdrejta dhe individuale të kandidati është vendimi për kualifikimin ose ndalimin e tij dhe jo aktet ligjore ose nënligjore mbi bazën e të cilave disponohet kjo vendimarrje.

18. Në këndvështrim të sa më sipër, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae* për kundërshtimin e procesit gjyqësor, në objekt të të cilit ka qenë kontrolli i vendimit nr. 4/2019. Nën të njëjtën analizë, Kolegji çmon se edhe për sa u takon pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues lidhur me shfuqizimin e nenit 238 të ligjit nr. 115/2016, i cili, ndër të tjera, parashikon rregullat për ankimet kundër vendimeve për ndalimin e kandidimit, sipas të cilit ai bëhet në Gjykatën Administrative të Apelit dhe vetëm për shkelje të rënda (*pika 1*) dhe se vendimi i gjykatës në këtë rast është përfundimtar dhe i formës së prerë (*pika 2*), kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae*.

19. Nga ana tjetër, Kolegji vëren se kërkuesi ka kundërshtuar 7 vendime të KED-së për ndalimin e kandidimit të tij, të dhëna gjatë viteve 2019, 2020 dhe 2021 (nr. 79/2019, nr. 80/2019, nr. 81/2019, nr. 82/2019, nr. 30/2020, nr. 3/2021 dhe nr. 9/2021) në Gjykatën Administrative të Apelit në tre procese të tjera gjyqësore. Këto padi që kanë pasur në objektin e tyre aktet administrative individuale, me efekt të drejtpërdrejtë ndaj interesave të tij, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor janë rrëzuar nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimet nr. 200/2019, nr. 90/2020 dhe nr. 61/2021. Lidhur me këto vendime gjyqësore edhe pse ato janë bërë përfundimtare në kuptimin kushtetues nuk rezulton që kërkuesi t'i jetë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual për kundërshtimin e tyre. Në këtë pikë, Kolegji thekson se sipas nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese. Qëllimi i këtij neni të Kushtetutës është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatë (*shih vendimet nr. 40, datë 14.09.2023; nr. 8, datë 03.03.2022; nr. 54, datë 24.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i paraqitur prej kërkuesit nuk mund të pranohet për shqyrtim në seancë plenare, pasi kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae*.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja "b", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.